



VENDIM

Nr. 840, datë 3.12.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 114, DATË 31.1.2007,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E MASËS SË
KONTRIBUTEVE TË PERSONAVE, QË
VENDOSEN NË INSTITUCIONET
REZIDENCIALE PUBLIKE TË
SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES
SHOQËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3, të nenit 23, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 114, datë 31.1.2007, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “c”, e pikës 3, të kreut I, masa “500 (pesëqind) lekë” zëvendësohet me masën “1 000 (një mijë) lekë”.

b) Pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d” dhe “dh”, me këtë përmbajtje:

“d) Gratë viktima të dhunës në marrëdhëniet familjare, që nuk kanë të ardhura e që janë vendosur në institucionet rezidenciale publike, 3 000 (tre mijë) lekë në muaj.

dh) Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit, që nuk kanë të ardhura e që janë vendosur në institucionet rezidenciale publike, 3 000 (tre mijë) lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 841, datë 3.12.2014

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE
NGA RISQET LIDHUR ME DRIDHJEN
MEKANIKE NË VENDIN E PUNËS”⁷**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 2, shkronja “b”, 39, pika 1, shkronja “b” dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet lidhur me dridhjen mekanike në vendin e punës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet në varësi të tyre për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet 1 (një) vit pas hyrjes në fuqi.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE

**PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE
NGA RISQET LIDHUR ME DRIDHJEN
MEKANIKE NË VENDIN E PUNËS**

SEKSIONI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet për sigurinë dhe shëndetin, që krijohen ose mund të krijohen nga ekspozimi ndaj dridhjes mekanike.

2. Kërkesat e kësaj rregulloreje zbatohen për ndërmarrjet, vendet e punës dhe veprimtaritë në

⁷Ky vendim i Këshillit të Ministrave transponon direktivën e BE-së 2002/44/KE, të datës 25 qershor 2002, për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj risqeve që krijohen nga agjentët fizikë (dridhja). (Direktiva e gjashtëmbëdhjetë individuale, në kuptim të nenit 16(1) të Direktivës 89/391/KEE) (nr. CELEX 32002L0044).



të cilat punëmarrësit janë të ekspozuar ose mund të ekspozohen ndaj riskut të dridhjes mekanike gjatë punës së tyre.

3. Veprimtaritë që preken nga fusha e zbatimit të kësaj rregulloreje përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për mirëqenien sociale dhe rininë, brenda 4 (katër) muajve pas miratimit të kësaj rregulloreje.

Neni 2

Përkufizime

Për efekt të kësaj Rregulloreje:

a) “Dridhje mekanike” është një oshilacion mekanik rreth një pike ekuilibri. Në mjedisin e punës merret parasysh vetëm dridhja e transmetuar nga një mjedis i ngurtë në organizmin e njeriut.

b) “Dridhja dorë–krah” është dridhje mekanike e transmetuar në trupin e njeriut nëpërmjet duarve, që përbën risk për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësit, duke shkaktuar veçanërisht çrregullime vaskulare, të kockave ose artikulacioneve, neurologjike ose muskulare.

c) “Dridhja e të gjithë trupit” është dridhja mekanike, e cila, kur transmetohet në të gjithë trupin e njeriut, nëpërmjet këmbëve, vitheve, shpinës dhe pjesëve anësore të trupit, përbën risk, duke shkaktuar veçanërisht sëmundshmëri të fundshpinës dhe trauma të shtyllës kurrizore.

ç) “Ekspozimi ndaj dridhjes” është veprimi i dridhjes të punëmarrësi gjatë një periudhe kohe të përcaktuar.

d) “Ekspozimi ditor ndaj dridhjes” është ekspozimi ndaj dridhjes lidhur me një ditë pune prej 8 orësh, që mund të llogaritet sipas Shtojcës 2 të kësaj rregulloreje.

dh) “Vlera e veprimit të ekspozimit ditor A(8)veprimi” është vlera e ekspozimit ditor ndaj dridhjes në mjedisin e punës, e standardizuar në një periudhë reference prej 8 orësh, që mund të përbëjë risk për sigurinë dhe shëndetin dhe ku duhen marrë masa për zvogëlimin ose shmangien e ekspozimit.

e) “Vlera kufi e ekspozimit ditor A(8)kufi” është vlera e ekspozimit ditor ndaj dridhjes, e standardizuar në një periudhë reference prej 8 orësh, e cila nuk duhet të tejkalohet për një punëmarrës gjatë ditës së tij të punës.

ë) “Vlera kufi e ekspozimit afat shkurtër A(0.5)kufi” është vlera e ekspozimit ndaj

dridhjes, e cila nuk duhet të tejkalohet për një punëmarrës gjatë një periudhe kohore prej 0,5 orë ose më të shkurtër, që mund të llogaritet sipas shtojcës 3 të kësaj rregulloreje.

f) “Autoritetet kompetente” janë institucionet përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin në punë, si të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Vlerat kufi të ekspozimit dhe vlerat e veprimit të ekspozimit

1. Vlerat kufi dhe vlerat e veprimit të ekspozimit për dridhjen dorë–krah janë:

a) Të përgjithshme:

- Vlera kufi e ekspozimit ditor, A(8)kufi është 5 m/s^2 ;

- Vlera kufi e ekspozimit afat- shkurtër A(0.5)kufi është 16 m/s^2 ;

- Vlera e veprimit e ekspozimit ditor A(8)veprim është $2,5 \text{ m/s}^2$.

b) Për gratë shtatzëna dhe punëmarrësit e mitur nën moshën 18 vjeç:

- Vlera kufi e ekspozimit ditor A(8)kufi është $1,4 \text{ m/s}^2$;

- Vlera kufi e ekspozimit afat -shkurtër A(0.5)kufi është 6 m/s^2 .

Ekspozimi i punëmarrësve ndaj dridhjes dorë-krah vlerësohet ose matet siç përcaktohet në pikën A të shtojcës 1.

2. Vlerat kufi dhe vlerat e veprimit të ekspozimit për dridhjen e të gjithë trupit janë:

a) Të përgjithshme:

- Vlera kufi e ekspozimit ditor A(8) kufi është $1,15 \text{ m/s}^2$;

- Vlera kufi e ekspozimit afatshkurtër A(0.5)limit është $4,6 \text{ m/s}^2$;

- Vlera e veprimit të ekspozimit ditor A(8)veprim është $0,5 \text{ m/s}^2$.

b) Për gratë shtatzëna, ekspozimi ndaj dridhjes për të gjithë trupin ndalohet.

c) Për punëmarrësit e mitur nën moshën 18 vjeç:

- Vlera kufi e ekspozimit ditor A(8)kufi është $0,3 \text{ m/s}^2$;

- Vlera kufi e ekspozimit afatshkurtër A(0.5)kufi është $1,1 \text{ m/s}^2$.

Ekspozimi i punëmarrësve ndaj dridhjes së të gjithë trupit vlerësohet ose matet siç përcaktohet në pikën B, të shtojcës 1.



SEKSIONI II DETYRIMET E PUNËDHËNËSIT

Neni 4

Vlerësimi i riskut

1. Punëdhënësi, në përputhje me nenin 9, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, siguron vlerësimin e risqeve që mund të shkaktohen nga dridhja mekanike, ndaj të cilit janë të ekspozuar punëmarrësit. Nëse pritet tejkalim i vlerës së veprimit të ekspozimit ditor, kryhen matjet e nevojshme të niveleve të dridhjes mekanike. Kjo realizohet në përputhje me pikën 2, të pjesës A, ose pikën 2, të pjesës B, të shtojcës 1, të kësaj rregulloreje, sipas rastit.

2. Niveli i ekspozimit ndaj dridhjes mekanike mund të vlerësohet nëpërmjet vrojtimit të praktikave specifike të punës dhe referimit tek informacioni përkatës mbi magnitudën e mundshme të dridhjeve që i korrespondon pajisjeve ose llojeve të pajisjeve të përdorura në kushte të veçanta të përdorimit, përfshirë informacione të ofruara nga prodhuesi i pajisjes. Ky vlerësim dallohet nga matja, e cila kërkon përdorimin e aparateve specifike dhe të metodologjisë së përshtatshme.

3. Vlerësimi i riskut kryhet nga shërbime të specializuara sipas legjislacionit në fuqi, në intervalet e mëposhtme:

a) çdo vit, nëse vlerësimi i riskut tregon se vlerat e veprimit të ekspozimit janë arritur ose janë tejkaluar;

b) çdo dy vjet, nëse vlerësimi i riskut tregon se vlerat e veprimit të ekspozimit nuk janë arritur dhe 1/5 e vlerës kufi të ekspozimit është tejkaluar.

4. Nëse vlerësimi i riskut, i kryer dy herë në një interval prej 2 vitesh, tregon se 1/5 e vlerës kufi të ekspozimit nuk është arritur, punëdhënësi mund të mos e vazhdojë vlerësimin e mëtejshëm, me përjashtim të rasteve kur ka pasur ndryshime të rëndësishme, që e bëjnë vlerësimin e riskut të pavlefshëm, ose kur rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore tregojnë se kjo është e nevojshme.

Vlerësimi i riskut mund të përfshijë një justifikim nga ana e punëdhënësit që natyra dhe shkalla e risqeve të lidhura me dridhjen mekanike bëjnë të panevojshëm një vlerësim të mëtejshëm të detajuar të risqeve.

5. Gjatë kryerjes së vlerësimit të riskut, punëdhënësi i kushton vëmendje të veçantë aspekteve të mëposhtme:

a) nivelit, llojit dhe kohëzgjatjes së ekspozimit, përfshirë edhe çdo ekspozim ndaj dridhjeve të ndërprera ose goditjeve të përsëritura;

b) vlerave kufi të ekspozimit dhe vlerave të veprimit të ekspozimit, të përcaktuara në nenin 3, të kësaj rregulloreje;

c) çdo efekti mbi sigurinë dhe shëndetin e grupeve veçanërisht të ndjeshme të punëmarrësve;

ç) çdo efekti indirekt mbi sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, që rezulton nga ndërveprimet mes dridhjeve mekanike dhe vendit të punës ose pajisjeve të tjera të punës, veçanërisht nëse dridhja çrregullon funksionimin normal të elementeve drejtues të pajisjes ose leximin e shenjave të vendosura, ose ndikon në qëndrueshmërinë e strukturës dhe sigurinë e makinerive;

d) çdo informacioni të ofruar nga prodhuesit e pajisjeve të punës;

dh) praninë së pajisjeve të tjera alternative të prodhuara për të reduktuar nivelet e ekspozimit ndaj dridhjes mekanike;

e) zgjatjes së ekspozimit ndaj dridhjeve të të gjithë trupit përtej kohës normale të punës nën përgjegjësinë e punëdhënësit;

ë) kushteve specifike të punës, të tilla si temperaturat e ulëta ose lagështia dhe të tjera;

f) informacionit të siguruar nga mbikëqyrja shëndetësore, përfshirë informacione të publikuara, kur kjo është e mundur;

6. Të dhënat nga vlerësimi dhe/ose matja e nivelit të ekspozimit ndaj dridhjes mekanike ruhen në formë të përshtatshme, që të jenë të disponueshme për përdorim të mëvonshëm, sipas legjislacionit në fuqi. Vlerësimi i riskut përditësohet rregullisht sipas shkronjave a dhe b, të pikës 3, të këtij neni, veçanërisht nëse ka pasur ndryshime të rëndësishme që e bëjnë atë të pavlefshëm, ose kur rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore tregojnë se kjo është e nevojshme. Vlerësimi i riskut përfshin edhe informacion mbi ndikimin e masave që duhen marrë, sipas neneve 5 e 6, të kësaj rregulloreje.



Neni 5

Shmangia ose zvogëlimi i ekspozimit ndaj dridhjes

1. Punëdhënësi garanton me preferencë që risku nga ekspozimi i punëmarrësve ndaj dridhjes të eliminohet në burim, dhe, kur kjo nuk është e mundur, të zvogëlohet në minimum, duke marrë parasysh progresin teknik dhe ekzistencën e masave për kontrollin e riskut në burim, bazuar në parimet e përgjithshme të parandalimit të riskut, sipas pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 10237, dt. 18.2.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”

2. Mbi bazën e vlerësimit të riskut, kur tejkalohen vlerat e veprimit të ekspozimit të përcaktuara në nenin 3 të kësaj Rregulloreje, punëdhënësi harton dhe zbaton një plan të masave teknike dhe/ose organizative, që synojnë zvogëlimin në minimum të ekspozimit ndaj dridhjes mekanike dhe risqeve të lidhura me të, duke marrë parasysh në veçanti:

a) metoda të tjera të punës, që mundësojnë ekspozim më të vogël ndaj dridhjes mekanike;

b) përzgjedhjen e pajisjeve të duhura të punës, me projektim të përshtatshëm ergonomik, që shkaktojnë dridhje në nivelin më të ulët të mundshëm, duke pasur parasysh punën që duhet kryer;

c) sigurimin e pajisjeve ndihmëse që reduktojnë riskun e dëmtimeve të shkaktuara nga dridhja, si ndenjëset, që në mënyrë të efektshme zvogëlojnë dridhjen e të gjithë trupit dhe dorëzat, që zvogëlojnë dridhjen e transmetuar në sistemin dorë- krah;

ç) plane të përshtatshme për mirëmbajtjen e pajisjeve të punës, vendit të punës dhe sistemeve të vendit të punës;

d) projektimin dhe organizimin e vendeve të punës dhe vendeve individuale të punës;

dh) informimin dhe formimin e përshtatshëm për të udhëzuar punëmarrësit mbi përdorimin e pajisjeve të punës në mënyrë korrekte dhe të sigurt, në mënyrë që ekspozimi i tyre ndaj dridhjes mekanike të zvogëlohet në minimum;

e) kufizimin e kohëzgjatjes dhe intensitetit të ekspozimit;

ë) grafikë të përshtatshëm të punës me periudha të mjaftueshme për çlodhje, ku punëmarrësit nuk ekspozohen ndaj dridhjes;

f) sigurimin e veshjeve mbrojtëse për punëmarrësit e ekspozuar ndaj të ftohtit dhe lagështisë.

3. Ekspozimi i punëmarrësve nuk lejohet të kalojë vlerat kufi të ekspozimit, sipas nenit 3, të kësaj rregulloreje.

Nëse konstatohen ekspozime mbi vlerat kufi të ekspozimit, punëdhënësi:

a) ndërmer veprime të menjëhershme për ta reduktuar ekspozimin nën vlerat kufi të ekspozimit;

b) identifikon arsyet përse ka ndodhur mbi ekspozimi;

c) merr masa për të parandaluar çdo përsëritje.

4. Punëdhënësi përshtat masat e përmendura në këtë nen me kërkesat e punëmarrësve me ndjeshmëri të lartë ndaj riskut.

Neni 6

Informimi dhe formimi i punëmarrësve

1. Në përputhje me nenin 12, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, punëdhënësi garanton që punëmarrësit e ekspozuar ndaj risqeve të dridhjes mekanike në punë, si dhe përfaqësuesit e tyre, të marrin informacion dhe formim të mjaftueshëm.

2. Informimi dhe formimi i punëmarrësve të ekspozuar përfshijnë në veçanti:

a) masat e marra për të shmangur ose zvogëluar në minimum risqet nga dridhja mekanike;

b) vlerat kufi të ekspozimit dhe vlerat e veprimit të ekspozimit;

c) rezultatet e vlerësimit të riskut, së bashku me një interpretim të tyre dhe risqeve potenciale;

ç) rëndësinë dhe mënyrën e konstatimit dhe raportimit të shenjave të dëmtimit;

d) rrethanat, në të cilat punëmarrësve u lind e drejta për mbikëqyrje shëndetësore, dhe qëllimin e kësaj mbikëqyrjeje, sipas nenit 8, të kësaj rregulloreje;

dh) grafikët e përshtatshëm të punës me periudha të mjaftueshme të çlodhjes pa ekspozim ndaj dridhjes.

e) praktikat e sigurta të punës për të minimizuar ekspozimin ndaj dridhjes mekanike.



Neni 7

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve

Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për konsultimin dhe pjesëmarrjen e punëmarrësve, në përputhje me nenin 13 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, në veçanti lidhur me vlerësimin e riskut dhe masat e marra, ose që duhen marrë për të shmangur ose zvogëluar ekspozimin ndaj zhurmës, në përputhje me nenet 4, 5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje.

**SEKSIONI III
DISPOZITA TË PËRZIERA**

Neni 8

Mbikëqyrja shëndetësore

1. Punëdhënësi merr masa për kryerjen e mbikëqyrjes shëndetësore të punëmarrësve, për të cilët vlerësimi i riskut tregon risk për shëndetin nga dridhja, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën përkatëse për sistemin e mbikëqyrjes shëndetësore, përfshirë kërkesat e specifikuar për kartelat e shëndetit në punë, dokumentimin dhe disponueshmërinë e tyre.

2. Mbikëqyrja shëndetësore dhe ekzaminimet mjekësore, rezultatet e të cilave merren parasysh në zbatimin e masave parandaluese në një vend pune të caktuar, synojnë parandalimin dhe diagnostikimin e shpejtë të çdo çrregullimi lidhur me ekspozimin ndaj dridhjes mekanike. Mbikëqyrja shëndetësore kryhet kur:

a) mund të provohet një lidhje ndërmjet ekspozimit ndaj dridhjes në vendin e punës dhe një sëmundje të identifikueshme ose efekteve të dëmshme mbi shëndetin;

b) është e mundur që sëmundje apo efekte të dëmshme të shkaktohen në kushte të veçanta të punës të një punëmarrësi dhe,

c) ekzistojnë ekzaminime specifike për diagnostikimin e sëmundjeve ose të efekteve të dëmshme për shëndetin.

Në çdo rast, punëmarrësit e ekspozuar ndaj dridhjes mekanike përtej vlerave të përcaktuara në nenin 3, të kësaj rregulloreje, kanë të drejtë për mbikëqyrje shëndetësore.

3. Lloji dhe shpeshtësia e ekzaminimeve mjekësore të përmendura në pikën 1, të këtij neni, janë përcaktuar në shtojcën 3, të kësaj rregulloreje.

4. Kur nga mbikëqyrja shëndetësore mjeku i punës konstaton së punëmarrësi ka një sëmundje të identifikueshme ose pasojë negative në shëndet, si rezultat i ekspozimit ndaj dridhjes mekanike në punë:

a) punëmarrësi informohet nga mjeku i punës mbi rezultatit e mbikëqyrjes shëndetësore që lidhet me të personalisht dhe, në veçanti, merr informacion dhe këshillim lidhur me çdo mbikëqyrje shëndetësore, së cilës duhet t'i nënshtrohet pas përfundimit të ekspozimit;

b) punëdhënësi informohet për çdo gjetje të rëndësishme nga mbikëqyrja shëndetësore, duke marrë parasysh konfidencialitetin mjekësor.

c) Punëdhënësi:

- rishikon vlerësimin e riskut;

- rishikon masat e parashikuara për të shmangur ose zvogëluar risqet, në bazë të nenit 5, të kësaj rregulloreje;

- merr parasysh çdo këshillë të dhënë nga mjeku i punës, nga një person me kualifikim të përshtatshëm ose nga autoriteti kompetent për zbatimin e masave për shmangien ose zvogëlimin e riskut, përfshirë mundësinë e caktimit të punëmarrësit në një punë tjetër, ku nuk ka risk për ekspozim të mëtejshëm ndaj dridhjes;

- siguron mbikëqyrje të vazhdueshme shëndetësore dhe ofron një ekzaminim të shëndetit të çdo punëmarrësi tjetër, i cili ka qenë i ekspozuar në mënyrë të ngjashme, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për mbikëqyrjen shëndetësore.

5. Të dhënat e mbikëqyrjes shëndetësore, përfshirë konkluzionet mbi aftësinë për punë për secilin punëmarrës, dokumentohen dhe përditësohen nga mjeku i punës, në përputhje me legjislacionin për mbikëqyrjen shëndetësore dhe atë për mbrojtjen e të dhënave personale, në mënyrë që të jetë i mundur shqyrtimi i tyre i mëvonshëm. Punëmarrësi, me kërkesë të tij, ka akses te të dhënat e kartelës së tij të shëndetit në punë. Kopje të kartelave të shëndetit në punë i vihen në dispozicion autoritetit kompetent me kërkesë të këtij të fundit.

Neni 9

Sanksionet

Në rast të shkeljes së dispozitave të ndodhura në këtë rregullore, zbatohen sanksionet e përcaktuara në nenin 43, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.



SHTOJCA I

A. DRIDHJA DORË-KRAH

1. Vlerësimi i ekspozimit

Vlerësimi i nivelit të ekspozimit ndaj dridhjes dorë–krah bazohet në llogaritjen e vlerës ditore të ekspozimit, të standardizuar në një periudhë reference prej tetë orësh A(8), të shprehur si rrënja katrore e shumës së katrorëve ose mesatarja kuadratike (r.m.s) (vlera totale) e vlerave të nxitimit të ponderuara sipas frekuencës, të përcaktuar në akset ortogonale ahwx, ahwy, ahwz, siç përcaktohet në Shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje dhe/ose në standardin e harmonizuar shqiptar, si EN ISO 5349-1: Dridhja mekanike—Matja dhe vlerësimi i ekspozimit të njeriut ndaj dridhjes së transmetuar nëpërmjet dorës – Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme.

Vlerësimi i nivelit të ekspozimit mund të kryhet mbi bazën e një vlerësimi të bazuar në informacionin e dhënë nga prodhuesit lidhur me nivelin e emetimit nga pajisjet e punës të përdorura, dhe bazuar në vëzhgimin e praktikave specifike të punës për matjen.

2. Matja

Kur matja kryhet në përputhje me nenin 4, të kësaj rregulloreje:

a) Metodot e përdorura mund të përfshijnë modelin e procedurës dhe numrit të kryerjes së matjeve të njëpasnjëshme, që përfaqëson ekspozimin personal të një punëmarrësi ndaj dridhjes mekanike në fjalë; metodat dhe aparati i përdorur duhet të përshtatet me karakteristikat e veçanta të dridhjes mekanike që duhet matur, ndaj faktorëve të mjedisit dhe me karakteristikat e aparatit matës, sipas standardit ISO 8041: Përgjigja njerëzore ndaj dridhjes – instrumentet e matjeve.

b) Në rastin e pajisjeve, të cilat kanë nevojë të mbahen me të dyja duart, matja duhet kryer në secilën dorë. Ekspozimi përcaktohet duke iu referuar vlerës më të lartë prej të dyjave; jepet gjithashtu informacion për dorën tjetër.

3. Interferenca

Germa “d” e pikës 4 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje do të zbatohet, në veçanti kur dridhja mekanike interferon me funksionimin normal të kontrolleve ose leximin e treguesve.

4. Risqet indirekte

Germa “d” e pikës 4 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje zbatohet në veçanti kur dridhja mekanike interferon me stabilitetin e strukturave ose sigurinë e elementeve bashkues.

5. Mbrojtësit individualë

Pajisjet mbrojtëse personale kundër dridhjes dorë-krah mund të kontribuojnë në planin e masave të referuara në pikën 1 të nenit 5 të kësaj Rregulloreje.

B. DRIDHJA E TË GJITHË TRUPIT

1. Vlerësimi i ekspozimit

Vlerësimi i nivelit të ekspozimit ndaj dridhjes në të gjithë trupin bazohet në llogaritjen e ekspozimit ditor A (8), të shprehur si nxitim ekuivalent i vazhdueshëm mbi një periudhë prej tetë orësh, llogaritur si vlera më e lartë (r.m.s.), e përcaktuar në tri akse ortogonale (1.4 awx, 1.4 awy, awz) për punëmarrësit e ulur ose në këmbë, në përputhje me standardin ISO 2631-1: Dridhja mekanike dhe shoku—Vlerësimi i ekspozimit të njeriut ndaj dridhjes së të gjithë trupit– Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme.

Vlerësimi i nivelit të ekspozimit mund të kryhet mbi bazën e një vlerësimi të bazuar në informacionin e dhënë nga prodhuesit lidhur me nivelin e emetimit nga pajisjet e punës të përdorura dhe bazuar në vëzhgimin e praktikave specifike të punës ose në matje.

2. Matja

Kur matja realizohet në përputhje me pikën 1 të nenit 4 të kësaj rregulloreje, metodat e përdorura, mund të përfshijnë procedurën dhe numrin e kryerjes së matjeve të njëpasnjëshme, që duhet të përfaqësojë ekspozimin personal të një punëmarrësi ndaj dridhjes mekanike në fjalë. Metodot e përdorura duhet të përshtaten me karakteristikat e veçanta të dridhjes mekanike që do matet, me faktorët e mjedisit dhe me karakteristikat e aparatit matës, në përputhje me standardin e harmonizuar shqiptar, si ISO 8041: 2005/AC (Përgjigja njerëzore ndaj dridhjes– instrumentimi i matjes).

3. Interferenca

Germa “ç” e pikës 4 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje zbatohet në veçanti kur dridhja mekanike interferon me operimin normal të kontrolleve ose leximin e treguesve.

4. Risqet indirekte

Germa “ç” e pikës 4 të nenit 4 të kësaj rregulloreje zbatohet, në veçanti kur dridhja



mekanike interferon me stabilitetin e strukturave ose sigurinë e elementeve bashkues.

5. Zgjatja e ekspozimit

Germa “e” e pikës 4 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje zbatohet, në veçanti kur për shkak të natyrës së veprimtarisë, një punëmarrës

përfiton nga përdorimi i mjediseve të çlodhjes që janë të mbikëqyrura nga punëdhënësi; ekspozimi ndaj dridhjes së të gjithë trupit në këto mjedise duhet të zvogëlohet në një nivel që është në përputhje me qëllimin dhe kushtet e përdorimit të tyre, përveç rasteve të “forcës madhore”.

SHTOJCA II FORMULA PËR LLOGARITJEN E EKSPOZIMIT NDAJ DRIDHJES

1. Ekspozimi ndaj dridhjes dorë-krah

a) Ekspozimi ditor ndaj dridhjes Dorë-krah

$$A(8)_{HA} = \sqrt{\frac{1}{T_0} \sum_{i=1}^n a_{hvi}^2 \cdot T_i}$$

$A(8)_{HA}$ – ekspozimi ditor ndaj dridhjes dorë -krah, në (m/s^2) .

a_{hvi} – vlera totale e mesatares kuadratike të nxitimit të ponderuar² në frekuencë për kohëzgjatjen T_i të operacionit të i -të, vlera totale e dridhjes dorë-krah, në m/s^2 .

$$a_{hvi} = \sqrt{a_{hwxi}^2 + a_{hwyi}^2 + a_{hwzi}^2}$$

a_{hwxi} , a_{hwyi} , a_{hwzi} – mesatarja kuadratike e nxitimit të ponderuar⁸ në frekuencë në drejtimin x, y, z , për kohën T_i të operacionit të i -të, në m/s^2 .

T_i – kohëzgjatja e operacionit të i -të.

T_0 – kohëzgjatja referencë -480 min (8 orë = 28800 s).

n – numri i ekspozimeve individuale ndaj dridhjes.

b) Ekspozimi afatshkurtër ndaj dridhjes dorë-krah

$$A(0.5)_{HA} = a_{hvmax} = \max \left\{ a_{hvi} \right\} \max \left\{ a_{hv1}, a_{hv2}, \dots, a_{hvn} \right\}$$

$A(0.5)_{HA}$ – ekspozimi afat-shkurtër ndaj dridhjes dorë-krah, në m/s^2 .

a_{hvi} – vlera totale e mesatares kuadratike të nxitimit të ponderuar² në frekuencë për kohëzgjatjen T_i të operacionit të i -të prej më pak se 0.5 orë, në m/s^2 .

2. Ekspozimi ndaj dridhjes së të gjithë trupit

a) Ekspozimi ditor ndaj dridhjes së të gjithë trupit

$$A(8)_{WB} = \sqrt{\frac{1}{T_0} \sum_{i=1}^n a_{vi}^2 \cdot T_i}$$

$A(8)_{WB}$ – ekspozimi ditor ndaj dridhjes së të gjithë trupit, në m/s^2 .

a_{vi} – vlera totale e mesatares kuadratike të nxitimit të ponderuar³ në frekuencë për kohëzgjatjen T_i të operacionit të i -të, vlera totale e dridhjes së të gjithë trupit, në m/s^2 .

$$a_{vi} = \sqrt{(1.4a_{wxi})^2 + (1.4a_{wyi})^2 + a_{wzi}^2}$$

2 nxitimi i ponderuar është nxitimi i dridhjes i përftuar duke përdorur funksionin e peshimit të frekuencës W_h (sipas standardit EN ISO 8041).



a_{wxi} , a_{wyi} , a_{wzi} – mesatarja kuadratike e nxitimi të ponderuar⁹³ në frekuencë në drejtimin x , y , z , për kohëzgjatjen T_i të operacionit të i -të, në m/s^2 .

T_i – kohëzgjatja e operacionit të i -të, min.

T_0 – kohëzgjatja referencë - 480 min (8 orë = 28800 s).

n – numri i ekspozimeve individuale ndaj dridhjes.

b) Ekspozimi afat- shkurtër për dridhjen e të gjithë trupit

$$A(0.5)_{WB} = a_{v\max} = \max \left\{ \mu_{v_i} \right\} \max \left\{ \mu_{v_1}, a_{v_2}, \dots, a_{v_n} \right\}$$

$A(0.5)_{WB}$ – ekspozimi afat- shkurtër për dridhjen e të gjithë trupit, në m/s^2 .

a_{vi} – vlera totale e mesatares kuadratike të nxitimit të ponderuar në frekuencë për kohëzgjatjen e_i -të të operacionit prej më pak se 0.5 orë, në m/s^2 .

SHTOJCA III MBIKËQYRJA SHËNDETËSORE PËR PUNËMARRËSIT E EKSPOZUAR NDAJ DRIDHJES

1. Kontrolli mjekësor paraprak dhe periodik për punëmarrësit e ekspozuar ndaj dridhjes dorë-krah përfshin këto ekzaminime:

- Të përgjithshme, që i kushtojnë vëmendje sistemit vaskular, atij nervor dhe strukturës kockore në gjymtyrët e sipërme,

- Mbështetëse: teste të ftohjes së duarve me termometër dermik, teste të kompresimit; vlerësim i pragut të perceptimit vibrotaktil, radiografi e duarve dhe artikulacioneve të bërrylit.

Kur periudha e ekspozimit ndaj dridhjes dorë-krah në punë zgjat më pak se pesë vjet dhe testi i fundit periodik nuk ka treguar ndryshime që tregojnë zhvillimin e sëmundjeve si pasojë e dridhjes, nuk ka nevojë të kryhen radiografi të kockave të duarve dhe artikulacioneve të bërrylit.

2. Ekzaminimet mjekësore paraprake dhe periodike për punëmarrësit e ekspozuar ndaj dridhjes së të gjithë trupit përfshijnë ekzaminimet e mëposhtme:

- Të përgjithshme: ekzaminime neurologjike;

- Mbështetëse: radiografi të fund-shpinës, në përputhje me indikacionet mjekësore.

3. Ekzaminimet mjekësore periodike duhet të kryhen në intervalet e mëposhtme:

- Për punëmarrësit e ekspozuar ndaj dridhjes dorë krah: ekzaminimi i parë pas një viti pune, dhe më pas çdo 4 vjet;

- Për punëmarrësit e ekspozuar ndaj dridhjes së të gjithë trupit: çdo 4 vjet.

⁹³Nxitim i ponderuar i përftuar duke përdorur funksionin e mëposhtëm të peshimit të frekuencës: W_d për drejtimet (horizontale) x dhe y , W_k për drejtimin (vertikal), z (sipas standardit EN ISO 8041.)